

# DETAJE

Gazetë e publikuar nga OSBE-ja

Edicioni 4 Nr. 2, Prill - 2004

## Më shumë përqëndrim në rini dhe në mekanizma për paralajmërim të hershëm

Prioritetet e reja të OSBE-së pas trazirave të 17-18 marsit, emërtimi si "një goditjeje të tmerrshme" nga shefi i Misionit të OSBE-së

nga Arni Snaevarr

Misioni i OSBE-së do të paraqesë fushatën kryesore të politikës së re: rinisë dhe arsimit, si pjesë e rishqyrtimit të punës së vet si njëra nga shtyllat e administratës së UNMIK-ut për ndërtim të institucioneve në Kosovë. Duke paralajmëruar reformat në një seancë të jashtëzakonshme të këshillit të përhershëm të OSBE-së më 30 mars, ambasadori Paskal Fieski, shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë e cilësoi dhunën e 17 dhe 18 marsit si "një goditje të tmerrshme për komunitetin ndërkombëtar në Kosovë".

"Turma të rinjesh qenë akterë kryesorë në ngjarjet e fundit, por jo edhe organizatorë" tha Ambasador Fieski para këshillit. "Kjo rini pasqyron të ardhmen e Kosovës dhe ne duhet që të ndihmojmë urgjentisht në gjetjen e së ardhmës si dhe të pengojmë porositë e urrejtjes dhe jotolerancës. Përqëndrimi më i madh në arsim padyshim do të formojë një pjesë kryesore të këtij aktiviteti të ri, por ne duhet të adresojmë më shumë pyetje të përgjithshme për edukatën qytetare dhe vend personal në shoqëri."



Demonstrues të rinjë gjatë trazirave të marsit në qytetin e Mitrovicës/Kosovë. Fotografia UN-it.

### NË KËTË NUMËR

Mes dy zjareve fq. 3

Vdekja e dytë e një artisti fq. 4

Shpërthimet në Kosovë .... drejtpërdrejt në TV fq. 7

Kampi dimëror shumetnik fq. 12

OSCE

### Mungesa e rezultateve në media

Shefi i Misionit të OSBE-së i tha këshillit të përhershëm se kriza kërkoi ndryshime në punën e OSBE-së në lidhje me mediat dhe shoqërinë civile. "Ne e pranojmë se rezultatet e punës sonë në zhvillimin e mediave kanë qenë më të vogla se sa që kemi shpresuar," tha ambasador Fieski duke paralajmëruar mbajtjen e një konference donatorësh për mediat e Kosovës. Për të vlerësuar "pse rezultatet tona kolektive nuk ishin më të mira, dhe si të përmirësohen ato."

Duke theksuar se Misioni i ka kushtuar vëmendje të madhe OJQ-ve të Kosovës, z. Fieski ka pranuar se efektshmëria e shoqërisë civile në ngjarjet e fundit ishte zhgënjyese. "Ne do të ri-sprovojmë partnerët tonë të shohin se cili nga ata duhet të vazhdojë të marrë ndihmë."

z. Fieski theksoi se Kosova demokratike shumë etnike ka mbetur politikë e OSBE-së por duhet të "rikonsiderohet një strategji realiste për promovimin e kësaj objekteve."

### Mekanizmat e paralajmërimit të hershëm

Përfundimisht shefi i Misionit deklaroi se mekanizmat e paralajmërimit të hershëm do të përmirësohet, duke shtuar monitorimin e mediave, jo më pak në shkallën vendore dhe përfundimisht në prezencën e OSBE-së në terren. "Ne do ta zgjerojmë rrethin tonë të bashkëbiseduesëve dhe burimet për të përfshirë më shumë zëra negativ në shoqërinë e Kosovës" tha ambasador Fieski "dhe ne do të ri-caktojmë për raportim dhe monitorim të disa përpjekjeve të cilat ne do ia kushtojmë ngritjes së kuadrove profesionale dhe dhënjën e këshillave. Por paralajmërimi i hershëm nuk do të jetë kurrë i përsosur. Askush nuk mund të parashikojë datën dhe kohën kur ndonjë shoqëri e veçantë do të humbë kontrollin."

z. Fieski i tregoi këshillit të përhershëm se këto vendime janë marrë pasi që është bërë një vlerësim paraprak, bazuar mes tjerash në

vijon në faqën 2

## Të dashur lexues

Në numrin e marsit të 'Detaje'-ve ne kemi shkruar për kthimin e Vukosava Mitroviqit në Prishtinë, një serbe 68 vjeçar, e cila për herë të parë pas pesë vitesh ishte në gjendje të festoj ditëlindjen në shtëpinë e saj. Dy muaj më parë shpresohej se kjo do të përcillej me kthimin e shumë serbëve të tjerë të zhvendosur të Kosovës. Fatëkeqësisht kjo është vënë në pikpyetje pas trazirave të cilat filluan më 17 Mars.

Ky numër i 'Detaje'-ve kryesisht i përkushtohet pasojave të këtyre ngjarjeve. Misioni i OSBE-së në Kosovë pranon se këto ngjarje ishin një goditje e rëndë për ne dhe për tërë komunitetin ndërkombëtar. Ne kemi filluar të analizojmë shkaktaqet dhe pasojat, dhe të bëjmë hapat e parë për të reformuar punën tonë në pajtim me konkluzionet tona.

### vijon nga faqja 1

intervistat që janë bërë javën e 22-26 marsit me popullatën nga Misioni i OSBE-së.

Këto janë pikat kryesore të vlerësimit:

### Nacionalizmi i organizuar dhe dështimi i pajtimit

Vëzhguesit pajtohen se, megjithëse demonstratat filluan si një shpërthim spontan, organizatorët u shfaqën shpejt mes demonstruesëve që të drejtojnë ata. Organizatorët ishin një numër i vogël i radikalëve të organizuar mirë. Ishte një efikasitet i radikalëve, që lejoi protestat të zgjasin emocionet e 17 marsit dhe vazhdojnë më 18 dhe 19 mars si një përpjekje e organizuar.

### Statusi i pazgjidhur

Statusi i pazgjidhur i Kosovës është dhënë shpeshëherë si një nga arsëyet për frustrim publik. Si dy motive kryesore prapa protestave janë marrë referimi i liderëve politik vendor dhe i komentatorëve herë pas herë për pavarësinë e Kosovës dhe ekzistenca e strukturës paralele serbe. Mirëpo, shkaktari kryesor i dhunës duhet të kërkohet më thellë.

### Rinia, mungesa e arsimit të duhur dhe papunësia

Me një shkallë të lartë të papunësisë, rinia shqiptare e Kosovës natyrisht që është përplotë me ankesa për gjendjen e tanishme ekzistuese. Në shtëpi, shumë të rinjëve u janë treguar rrëfime që paraqesin serbin si armik të vjetër. Shkollat monoetnike gjithashtu janë përgatitje e dobët për një jetë shumë etnike.

Në fakt, konstatimet fillestare tregojnë se shumë shkolla nuk kanë bërë asgjë për të ndaluar nxënësit që të mos dalin në demonstrata. Mirëpo ka pasur edhe nxitje nga mësimdhënësit për t'iu bashkangjitur protestave.

### Gjendja ekonomike

Zhvillimi i përgjithshëm i vendit për banor i llogaritur në vitin 2003 ka qenë 700 euro, dhe shkalla e papunësisë ka gjasa të jetë e lartë afër 70 përqind. Indikatorët kanë filluar të sugjerojnë se në vitin 2004 ekonomia do të jetë në rënje - prodhimet vendore nuk janë duke u rritur me

Artikujt të cilët ju do t'i lexoni kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të ngjarjeve: reformat e punës të Misionit të OSBE-së, rolin e mdiave elektronike, telashet e të zhvendosurve si dhe viktimve tjera të dhunës. Ne japim tregime të individëve; punonjës të OSBE-së, tregojnë për përjetimet e tyre kur dhuna goditi. Ne dëshmojmë se si përfundoi kampi dimëror në Brezovicë kur fëmijët u detyruan të kthehen në shtëpitë e tyre përmes barrikadave dhe nën përcjellje ushtarake.

Të dashur lexues, Misioni i OSBE-së në Kosovë edhe përkundër kësaj pengese, do të vazhdoj punën e vet si shtyllë e tretë e administratës së UNMIK-ut për ndërtimin e institucioneve. Ne ishim të dëshpruar nga veprimet e disa prej partnerëve tanë në Kosovë dhe ne duhet t'i rivlerësojmë dhe t'i përshtatim politikat tona në përputhje me rethanat. Ne do të mësojmë nga kjo përvojë e hidhur dhe do t'i dyfishojmë përpjekjet tona për t'i ndihmuar njerëzit e Kosovës në ndërtimin e një Kosove demokratike dhe shumetnike, ku njerëzit të mund të jetojnë në paqë dhe siguri të plotë pa marrë parasysh origjinën e tyre.

shpejtësi të duhur për të kompensuar rënjet në mjetet e dërguara nga diaspora dhe të ardhurat e dobësuara nga prezenca ndërkombëtare. Gjendja ekonomike e pashpresë gjithashtu ka çuar deri të kërkimi i fajit dhe minoriteti del në shënjestër.

### Mediat

Mënyra se si u paraqit në media mbyjtja e tre fëmijëve në lumin Ibër mund të konsiderohet si një kontribut i drejtëpërdrejt për nxitje të dhunës. Me fillimin e dhunës, stacionet televizive transmetuan raporte senzacionale dhe intervista nxitëse. Ky raportim shumë emocional kontriboi në keqësimin e situatës.

### Puna dhe rënja e popullariteti të komunitetit ndërkombëtar

Komuniteti ndërkombëtar në Kosovë u kritikua shumë nga të gjitha shtresat e shoqërisë kosovre, por me zë të lartë nga mediat. Shkaktarët e paknaqësive janë mungesa e vendeve të punës, përciptimi i ngecjeve politike, toleranca e strukturave paralele për serbët e Kosovës dhe polemikat e kohëve të fundit rreth procesit të privatizimi.

### Shkëputja mes autoriteteve vendore dhe popullatës në përgjithësi

Kur dhuna shpërtheu shumë udhëheqës politik ishin të befasuar, të tronditur dhe të pafuqishëm. Kjo paaftësi e autoriteteve të zgjedhura për të paraparë, parandaluar ose kontrolluar dhunën paraqet shkëputje mes popullatës dhe institucionit politik. Autoritetet vendore dhe partitë politike janë kuptuar si joefikase, jo përfaqësuese dhe jo në kontakt të duhur me popullatën.

### Ndjenja e pandëshkueshmërisë

Pjesëmarrësit ishin të trimëruar për të marrë pjesë në incidente nga ndjenja e 'pandëshkueshmërisë' trashëguar pas ngjarjeve të vitit 1999. Krimet ndëretnike, ose më sakt, krimet të cilat ishin menduar që të jenë të tilla, ende janë të vështira për tu zgjidhur sepse dëshmitarët nuk paraqiten, dhe shumica e serbëve të Kosovës të cilët kanë ikur në vitin 1999 nuk janë kthyer më.

### Frika nga e kaluara

Shqiptarët e Kosovës kanë frikë se do të kthehet gjendja që ka qenë para vitit 1999. Serbët e Kosovës, të cilët pranojnë shërbime të caktuara nga shteti (të përshkruara në mënyrë të përgjithshme në Kosovë si 'struktura paralele'), rezultojnë të kuptohet se ata nuk e pranojnë integrimin në shoqërinë e Kosovës.

## DETAJE

Gazetë e publikuar nga OSBE-ja

Rruga Beogradi 32 38000 Prishtinë Tel: (+381-38) 500 162

Fax: (+381-38) 500 188

E-mail: [press@omik.org](mailto:press@omik.org)

Botuesi:

Sven Lindholm

Kryeredaktorë:

Arni Snaevarr

Redaktorë:

Hasan Sopa & Slavisha Mladenović

Disenji & faqosja:

Shpend Kada

Bashkëpunorë:

Kreshnik Basha, Edita Buçaj, Doina Gimic,  
Patrik Hofman, Biserka Ivanović, Majkell Kerbi,  
Ndeim Pasuli, Shenad Sabović, Mevlyde Salihi,  
Olivera Stojanović, Bernard Vrbani, Franklin de Vrieze



Mission in Kosovo

Shënim:

Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

# Mes dy zjarreve

Të zhvendosurit gjatë trazirave të fundit në Kosovë pyesin se a duhet të ikin nga Kosova drejt një të ardhme të pasigurtë apo t'ia japin Kosovës edhe një shancë

**Nga Ola Stojanović dhe Mustafa Skenderi**

“E si mund të ndihem tani?” Ilija Todorović (53) i përgjigjet pyetjes sonë me një pyetje tjetër, kur e takuam gjersa pinte cigare para derës bojë hiri të një konteneri refugjatësh. “Ndërton shtëpinë e pastaj e shikon derisa digjet dhe zhduket për vetëm 15 minuta. Pra, mund të paramendoni se si ndihem”, vazhdoi ai.

Me gruan e tij dhe rreth 30 serb nga Prishtina, Fushë Kosova, Obiliqi dhe Kishnica, ai është strehuar në një nga 15 kontenerët në objektin e ndërmarrjes ‘Voçar’ në Graçanicë. Këto baraka të improvizuara, të pajisura me disa shtretër, tavolina dhe karriga, janë strehë e përkohëshme për këta persona të zhvendosur rishtazi.

Sipas raporteve zyrtare të policisë, të shpallura me 31 mars, shifrat e përafërta të trazirave të dhunshme janë si vijon: 19 të vdekur, më shumë se 900 të lënduar, 30 kisha ortodokse dhe manastire dhe rreth 800 shtëpi të djegura ose të shkatërruara.

Gjatë trazirave të fundit, shtëpitë e këtyre njerëzve janë djegur, shkatërruar ose janë plaçkitur kurse në disa raste, “kthimi është i pamundur për shkak të pasigurisë.”

Ata që janë zhvendosur kanë gjetur strehim në kampet e KFOR-it, në ndërkohë që kërkojnë një zgjidhje afatgjatë.

Gazetarët e ‘Detaje’-ve u ndeshen me pamje dëshpëruese të mbetura nga ngjarjet e dhunshme. Disa shtëpi digjet akoma, ndërsa tymi dilte nga shtëpitë dhe fermat tjera. Asnjë shenjë nga banorët të cilët ishin transferuar në kampet të improvizuara.

“Kemi fletur në kamp, duke kapërcyer mbi njëri tjetrin. Ishte e tmerrshme. KFOR-i na ka dhanë ushqim. Ishte mjerim për fëmijët, mandej kishte edhe foshnje,” na thanë të zhvendosurit gjatë vizitës sonë të parë menjëherë pas ngjarjeve.

Atmosfera ishte e ngjashme edhe në enklavat serbe përreth.

Shumica e personave që ishin strehuar në Llapllasellë dhe Preoc ishin nga Obiliqi dhe Çagllavica. Sërgjani (24) na tha se vetëm disa ditë më parë ai kishte qenë në Prishtinë me shokët e tij shqiptarë, sot ishte në Preoc, pa



“Mezi po i’a dalin”, në një kamp të zhvendosurish në Graçanicë. Fotografia: Ola Stojanović

shtëpi, pa asgjë. “Nuk mund të besoj se kjo më ka ndodhur mua. Dua vetëm të iki nga këtu, kudoqoftë,” shtoi ai. “Nuk i besoj më askujt.”

Graçanica, enklava më e madhe serbe, ka strehuar numrin më të madh të të zhvendosurve. Këta njerëz kalonin ditët e tyre duke vizituar njëri tjetrin, dhe duke provuar të kuptojnë çfarë me të vërtetë u kishte ndodhur. “Nga një kafaz, jemi transportuar në një tjetër. Mendohej të mos mendoj për këtë por pamjet e kishës në flakë, fshehja dhe ikja nga shtëpia kalojnë nëpër mendjen time vazhdimisht,” tha Ilija Todorović për ‘Detaje’.

Gruaja e Ilijës ndërhyrë në bisedë kohë pas kohe. “Dua të kthehem, vetëm ta shikoj kishën, pamundësia për tu kthyer ma then zemrën,” thotë ajo e hidhëruar.

Vizita jonë u ndërpre për një çast kur dikush bërtiti: “dreka është gati!” Njerëzit marrin enët e tyre dhe nisen spontanisht drejt një kamioni të parkuar. Dera e prapme e kamionit hapet dhe era e ushqimit del që andej. Secili merr nga një pjatë ushqim dhe një copë bukë.

Ndihma humanitare në ushqim, dhe veshmbathje shpërndahet çdo ditë nga Kryqi i Kuq i Serbisë. Është vështirë të gjykojë kualitetin e ndihmës. Derisa disa janë të kënaqur se “më në fund diçka arriti, se përndryshe do të vdisnim urie,” të tjerët janë të zemëruar dhe ankohen duke treguar çizmet e dimrit të ndara nga Kryqi i Kuq. “Kemi dalur me pantofla kurse tani kemi marrë këto çizme. A mund të mbaten këto tani?”

Gjatë vizitës tonë pasuese në kampet e të zhvendosurve që nga ngjarjet e muajit të kaluar, kuptuam se shumë më shumë njerëz dëshironin të ktheheshin për t’iu ikur këtyre kushteve “jashtëzakonisht të rënda.”

“Dëshiroj të kthehem në banesën time, atje kam lënë gjithçka, nuk i frikësohem kthimit,” thotë Zhivorad Toniq nga Fushë Kosova, i cili ka gjetur strehim në kampin e Graçanicës, së bashku me gruan e tij dhe djalin e sëmurë mentalisht.

Megjithatë, gruaja e tij mendon ndryshe.

“Vetëm mendimi për të kthyer më bën të sëmurë. Kujtimet traumatizuese që i kam përjetuar më 17 mars, e vetmuar me djalin e sëmurë në banesën e demoluar, nuk do të më lënë asnjëherë. Fshiheshim në banjo dhe e mbështolla Dejanin, djalin tim, me një batanije që të mos hetoheshim,” shpjegon gruaja e Zhivoradit duke qarë.

Ljubisha Spasiq nga Obiliqi ishte zhvendosur një ditë pas 17 marsit. Edhe pse shtëpia e tij ishte djegur, ai viziton gërmadhat çdo ditë dhe dëshiron të qëndrojë. “Kam mbijetuar përpara, duke iu falendëruar fqinjëve shqiptarë të cilët më kanë sjellur ushqime. Mendoj se mund të jetoj këtu. Jam i sigurtë se mund të qëndroj edhe kësaj here.”

Është vështirë të gjykojë përfundimisht planet për të ardhmen e personave që janë të zhvendosur aktualisht. Sipas asaj që është thënë dhe dëgjuar, qëndrimet janë të ndryshme. Përderisa një numër i njerëzve dëshirojnë të kthehen, të tjerët janë të vendosur të kërkojnë kompenzim dhe ta lëshojnë Kosovën.

“Pas 48 vjet pune në pronën time në Kishnicë dhe një jete të përbashkët me të gjithë, gjithçka është shkatërruar. Tani krejt çka dua është që një komision të vlerësoj pronën time, të paguhem dhe të largohem nga Kosova përgjithmonë,” tha plaku Ljubomir Milenković.

Edhe pse ‘Detaje’ u botua përafërsisht një muaj pas këtyre ngjarjeve, një numër i caktuar i njerëzve tashmë po bëhen gati për tu kthyer në shtëpitë e renovuara, veçanërisht në ndërtesën ‘YU program-it’ në qendër të Prishtinës. Mbase, kjo është një reze shprese.



Kisha St. Nikola e djegur, Prishtinë  
Fotografia: Ola Stojanović



# Vdekja e dytë e një artisti

Bashkëshortja e të ndjerit Agim Çavdarbasha flet për 'vdekjen e dytë' të skulptorit kosovar i nohur edhe të arenën ndërkombëtare, galeria e të cilit është djegur tërsisht gjatë trazirave të marsit

nga Mevlyde Salihu



*"Ky është tmerri im", thotë Sebi, e veja e skulptorit Agim Çavdarbasha: "Pesë vite pas lufte ne e përjetuam vdekjen e dytë të Agimit"*

Photo: Hasan Sopa.



Hap portën dhe nxjerrë një ofshamë nga thellësia e shpirtit. Para nesh shfaqet ajo çka ka mbetur nga krijimtaria 40 vjeçare e skulptorit të ndjerë, Agim Çavdarbasha, pas djegjes së shtëpisë-atele në Çagllavicë, afër Prishtinës, gjatë trazirave të marsit.

"Ky është tmerri im," thotë Sebi, bashkëshortja e skulptorit. Gjatë këtyre ditëve të rënda për Kosovën, ku secili ka humbur nga diçka të shtrenjtë. Familja Çavdarbasha ka humbur një pjesë tepër të çmueshme të asaj që ka ruajtur me fanatizmin më të madh, skulpturat e Agimit. "Pesë vite pas luftës, përjetuam vdekjen e dytë të Agimit," shton ajo.

Agim Çavdarbasha ka qenë skulptori i parë shqiptar nga Kosova. Në vitin 1995, academia e shkencave dhe arteve të Kosovës kishte shpallur studion e akademikut Agim Çavdarbasha galeri të hapur. Galeria, e cila kishte pritur vizitorë të shumtë nga të gjitha viset e botës, iu kishte shpëtuar kohrave më të vështira për tu djegur deri në themel në pranverën e vitit 2004.

Shumë nga veprat më kapitale të këtij artistit janë djegur plotësisht. Njëra ndër skulpturat që janë shëndrruar në hi është edhe 'Përçafimi', skulpturë prej druri mbi dy-metërshe. Zjarrit i kanë shpëtuar kryesisht skulpturat nga mermëri. Fatmirësisht, edhe disa skulptura prej dru kanë mbetur të paprekura pasi që kanë qenë të ekspozuara në oborr të shtëpisë.

"Veprat më kapitale prej druri të Agimit si psh. 'Përçafimi', 'Familja', 'Gruaja me Fryte' e shumë të tjera, prej masave miniaturale deri në mbi dy metra, janë asgjësuar. "Vetëm hiri ka mbetur prej tyre," tregon Sebi dhe shton, "në çardak ka qenë e ekspozuar 'Sofra', vepër të cilën Agimi e ka konsideruar më kapitalen, e punuar në allçi, vepër nga tradita jonë, e cila është dëmtuar mjaft. Shpresoj se me ndihmën e institucioneve kulturore kjo vepër do të riparohet dhe derdhet në bronzë," shprehet ajo derisa tregon pjesë të mbetura të vepërës së preferuar të Agimit.

Agim Çavdarbasha ka qenë skulptor me përmasa ndërkombëtare. Përveq në Kosovë dhe rajon, puna e tij është mirëpritur edhe në shumë vende tjera të botës. Agimi kishte prezentuar me sukses artin e Ko-

sovës në Amerikë, Gjermani, Japoni bile edhe në Australi dhe Zelandë të Re.

Sipas zonjës Çavdarbasha, shtëpisë i është vënë zjarri me 19 mars, d.m.th. dy ditë pas trazirave, në ndërkohë që KFOR-i kishte kthyer kontrollin mbi fshat. Gjatë vizitës që i kishte bërë shtëpisë me 20 mars, ajo kishte gjetur shtëpinë në tym. "Sipas banorëve të cilët kanë pasur rastin të shohin, shtëpisë nuk i është vënë zjarri me datë 17, atë natë kur ka qenë euforia, spontanja dhe kur janë djegur shtëpitë tjera. Unë mendoj që shtëpisë i është vënë zjarri në mëngjesin e 19 marsit," thotë Sebi, plot mlllef. Sido që të jet, ajo dëshiron të marrë një shpjegim zyrtar nga KFOR-i. "Unë jam shumë e interesuar të kontaktoj KFOR-in e të shoh çfarë kanë për të thënë."

Sebi kishte plotësisht dëshirën e Agimit duke kthyer skulpturat aty ku e kishin vendin - në Çagllavicë - në vitin 2001. Veprat e Agimit kishin qëndruar në Shqipëri që nga viti 1993 pas një ekspozite individuale në kuadër të "Ditëve të Kulturës së Kosovës" atje. Kthimi i tyre, në vitin 2001, ishte bërë i mundur me ndihmën e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe të Shqipërisë, si dhe Galerive të Arteve të të dy vendeve. Asaj asnjëherë nuk i kishte shkuar mendja se skulpturat e të shoqit do të digjeshin në shtëpinë e tyre, aty ku Agimi i kishte gdhendur. "Nuk kam besuar se një gjë e tillë mund të ndodh, por ja që ndodhi."

Krijimtarinë e asgjësuar të Agimit nuk mund ta kthejë askush. Mirëpo, shpresa mbetet se skulpturat që i kanë mbijetuar zjarrit do të qëndrojnë aty ku kanë qenë gjithëmonë dhe do të kenë një mbikqyrje më të madhe.

Sebi kthen shikimin tek 'Sofra' e përgjysmuar e Agimit derisa mbyll portën e galerisë së bërë shkruab e hi.



*Shtëpia e artistit e djegur gjatë trazirave: "Unë kurrë nuk kam menduar se një gjë e tillë mund të ndodh"*

Photo: Hasan Sopa.

# Çka tani...?

nga Bernard Vrban

Stina e pranverës në Mitrovicë ka një histori të afërt, të errët dhe këndellëse. Qyteti i ndarë nga libri është dëshmitar i disa ngjarjeve më pikëlluese në Kosovë që nga përfundimi konfliktit. Kjo pranverë/dimër i vonë tregoi edhe një here se armiqësitë në mes të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës janë ende të forta, përkundër përpjekjeve të mëdha të bashkësisë ndërkombëtare që t'i pajtojnë komunitetet këtu.

## Lajmëtari i trazirave

Të mërkurën, më 17 mars, veq kishte shenja për trazira të mundshme. Kur unë shkova në zyrën e OSBE-së atë mëngjes të hershëm, rojët e ndërtesës më pyetën se a kisha dëgjuar për vdekjen a tre fëmijëve shqiptarë në komunën me shumicë serbe, Zubin Potok. Sipas njërit prej tyre, RTK (emetuesi publik) kishte raportuar një natë më parë se serbët i kishin ndjekur fëmijët me qen deri sa ishin ata zhytur në lumë, gjë e cila u përcoll me pasojat më të rrezikshme. Përkundër faktit se nuk kishte asnjë konfirmim nga policia se kjo ngjarje kishte ndodhur me të vërtetë, rrëfimi ishte pranuar si i vërtetë.

Pas pak, dola në qytet dhe u ula afër shetitorës në pjesën jugore të qytetit. Rreth orës 9:15h, disa nxënës me pankarta në duar të shoqëruar edhe nga mësuesit e tyre protestuan në mënyrë të qetë në qytet, kundër asaj që ata besonin se ishte edhe një krim tjetër ndër-komunal. Nuk vonoi shumë dhe njësitë ndërkombëtare i policisë speciale erdhin zhurmshëm në 'Zonën e Mirëbesimit', siq njihet këtu, dhe u stacionuan afër urës që çon për në veri.

Një grup njerëzish filloi të mblidhej tek ara duke valvitur flamurin shqiptar. Ata u kërcënuar se do ta kalojnë urën, gjë të cilën e bënë duke i thyer radhët e policisë në anën jugore. Ajo që pasoi pas kësaj ishte një betejë e vogël rrugë në pjesën veriore me serbët që ishin duke pritur. U shkëmbyen gurë dhe grushta, por të dy palët ishin të ndara fizikisht secila në anën e saj të urës. Po të ishte ndalur pas 'gurëve dhe grushtave', shumë pak njerëz jashtë kosove do të kishin dëgjuar për këtë. Megjithatë, të gjithë tani kanë dëgjuar për rafallet e gjysmë-automatikëve dhe granatve që lan të vdekur 7 njerëz në ish-qytetin e minatorëve.

Stafi i OSBE-së shikonte i shokuar dhunën përmes dritares së katit të parë të zyrës. Ishim dëshmitarë edhe të një konflikti për të cilin kishim shpresuar dhe besuar se nuk do të përsëritej më.

Njësitë policore gjithashtu u sulmuan nga të rinjtë shqiptarë, të cilin mundoheshin të çanin përpara përgjat shetitores. Kokteje molotovi u hodhën, kontejner bërllogu u vunë përball policisë dhe u bënë përpjekje që të ndizet një zjarrë përreth tyre. Tërë këtë, ne e shikonim nga kati i gjashtë i ndërtesës.

## Duke e shikuar se si po vdiste fshati

Dita tjetër, e enjte, kaloi në pritje. A do të ketë më përlëshje, a do t'i kthehen gjërat normalitetit dhe të gjithë ne t'i kthehemi punës sonë? Fatëmirësisht, ajo ditë kaloi pa trazira pasi që KFOR-i e kishte vënë qytetin nën kontroll dhe kishte vendosur orën policore. Megjithatë, raportimet edhe për një përlëshje të madhe e shtynë KFOR-in që të 'zhvendosë' të gjithë ndërkombëtarët (e OSBE-së, OKB-së, UNHCRS-së dhe agjencioneve tjera) në bazën e KFOR-it Francez në periferinë e pjesës jugore të Mitrovicës.

Mirëpo, kur arritëm në kampin e KFOR-it, të gjithë dëshiruam që të ishim në qytet. Në atë mënyrë, ne nuk do të ishim dëshmitarë të asaj që ndodhi në fshatin Frashër, që është i banuar gjysma me shqiptarë dhe gjysma tjetër me serbë. Fshati ishte rreth një kilometër poshtë nesh. Pamë nga kampi se si dilte flaka nga shtëpitë e serbëve dhe pastaj dëgjua rafalle. Banorët e fshatit ishin evakuuar pak para se turma e shqiptarëve arriti aty me autobusë (siq morëm vesh më vonë nga KFOR-i). Ne ishim të tmerruar kur pamë se si fshati digjej dhe shuhej.

Banorët serb të fshatit u vendosën me shpejtësi në bazën e KFOR-it francez. Ata kanë ngrënë dhe kanë fjetur në një pjesë të vogël të sallës që i'u ishte ndarë atyre. Pinin duhan dhe bisedonin. Ngushlloheshin në mes veti dhe thërrisnin të afërmit e tyre në vendet me shumicë serbe. Ata filluan që të lëvizin ngadal në majë të kodrës që të shihnin fshatin e tyre dhe ata

panë tmerrin më të madhe. Frashëri nuk egzistonte më.

## Rrënimi i kujtesës dhe ëndrrave

Me vite të tëra kam punuar në fushën humanitare dhe me persona të zhvendosur, por njeriu kurrë nuk mësohet me pikëllimin, vetmin dhe dëshprimin, gjë që mund të shiheshin në sytë e një plake e cila e dinte se kurrë më nuk do ta shihte shtëpinë e saj. E tëra që do t'i mbetët është flaka duke rrënuar kujtesën, ëndrrat dhe lumturinë. Njeriu kurrë nuk mësohet me këto.

Dhuna ishte shpërndarë në tërë Kosovën. Praktikisht, asnjë qytet që kishte banorë të pakicës serbe nuk kishte mbetur i paprekur. Kishat ortodokse, të cilat kishin mbijetuar edhe gjatë okupimit turk, ishin shkatërruar duke mos bërë dallim nga shtëpitë e serbëve, të cilët aty shkonin në mesha si dhe kremtonin pagëzimet dhe martesat e tyre.

## 'Çka tani?'

Ne qëndruam gjashtë ditë në kamp duke dëgjur radiot për të mësuar ndonjë lajm. Ne nuk mund të bënim gjë veçse të rrinim dhe prisnim për lirimin tonë. Megjithatë, ne të gjithë e denim, se pas lirimit, i cili pasoi një javë pas trazirave dhe dhunës, ne do të ballafaqoheshim me një Kosovë që do të ishte krejt ndryshe nga ajo që e lamë para se të shkonim në strehimore natën e parë. Ne e pyesnim dhe ende e pyesim veten - 'Çka tani?'



Fshati Frashër: I banuar me shqiptarë dhe serbë. Ne u tmerruam duke parë se si vdiste dhe shuhej ky fshat  
Fotografia e UN-it.



# Dua të zgjohem nga ky ankth!

Muaji mars më zgjoi kujtime të këqija nga e kaluara megjithëse këtë vit kjo frikë pat filluar të më kalojë. Mirëpo, ngjarjet që ndodhen muajin e kaluar ishin prova më e mirë se isha gënjer.

nga Edita Buçaj

Kur unë isha studente këtu në Prishtinë kisha përjetuar më të keqen që dikush mund ta pararendojë dhe kisha mbijetuar. Zoti e dinë si, por mbijetova. E vetme. Pas pesë vitesh një dorë e padukshme më ktheu prapa në atë kohë. Dhe nuk kam fuqi ta ndaloj.

Sa pata filluar t'i shlyejë ato kujtime. Tash po qeshem me naivitetin tim, dëshirat dhe shpresat. Diçka në kokën time kisha llogaritur gabimisht.

Kur filloi konflikti në vitin 1999 ndihesha njësoj. Kisha shumë shpresa se pas bisedimeve maratonike do të tejkalohet më e keqja dhe më jepte shpresë për të ecur përpara. Ajo që nuk e kuptoj është gabimi i një studenteje të re dhe optimiste se gjërat do të ndryshojnë.

Me muajtë të tërë ishim fshehur me shoqet që banoja nëpër vende të ndryshme dhe bodrume të Prishtinës. Të shumtën e kohës të uritura dhe duke na ndjekur forcat keqëbërëse.

Por si ta shpjegojë këtë tash?



*Pranvera kishte lulëzuar plotësisht dhe çdo gjë dukej normale atë ditë kur morëm lajmin....  
Fotografia e UN-it.*

## Udhëtim i shpejtë në të kaluarën

Pranvera filloi të lulëzojë dhe gjithëcka dukej normale atë ditë kur i dëgjuam lajmet se një serb i ri ishte plagosur gjatë udhëtimit në Çaglavicë, një fshat 5 km në jug të Prishtinës.

Gjatë protestave, serbët vendor bllokuan rrugën kryesore që e lidhë Kosovën qëndrore dhe lindore si dhe rrugën me Maqedoninë. Incidenti ishte për tu dënuar edhe policia "ende janë duke bërë hetime" për kryesit e mundshëm të veprës". Nga ana tjetër, protestat nuk ishin ndonjë lajm pasi që ky ishte një reagim periodik kurdo që ndodhin incidente të tilla.

Për t'u bërë gjërat edhe më keq, ne dëgjuam se për një incident në Çabër, fshat në veri të Kosovës, ku tre fëmijë shqiptar ishin mbytur në rrethana të paqarta. Një prej të mbijeturarëve deklaroi se ata i kishin ndjekur fëmijët nga fshati fqinjë Zubç i banuar me serbë.

Papritmas shpërtheu një dhunë e paparë. Lajmet vinin nga të gjitha anët për protesta, djegie, vrasje. Ku po jetoja unë?

Nuk e kisha të qartë qëllimin. Të gjithë? Kishte aq shumë konfuzion. Kudo në ajër. Në kokën time. Dhe askush nuk e ndalte...

Historia do të jet gjykatësja më e mirë.

## Në vend të ngjarjes

Me gjithë ato ngjarje është e arsyeshme se nuk ishim në gjendje të punojmë edhe aq. I telefonova kolegut tim serb dhe u gëzova që ai dhe familja e tij ishin shëndoshë e mirë.

Kolegët ndërkombëtarë me të drejtë ishin të

shqetësuar për fatin e vet dhe të minoritarëve. Ne merrnim raporte për djegie të automjeteve të UN-it dhe sulmit me gurë ndaj selisë së UNMIK-ut. Çka nuk më pëlqente ishte pozita në të cilën isha. Disa nga ndërkombëtarët më shiqonin sikur unë isha e kënaqur me atë që ndodhte; dhe kjo me të vërtetë më lëndonte. Isha mësuar të dëgjoj se nuk duhet të bëhet qortim kolektiv. Tash e shijoja këtë dhe ishte diçka shumë e hidhur.

Vendosa të dal nga zyra dhe të shoh se çka po ndodhte jashtë në terren. Me kartelë të OSBE-së nuk do të kisha problem. Dhe shfrytëzova rastin të udhëtoj me disa gazetarë ndërkombëtar.

Me një ekip suedez provuam urën e parë që e ndanë qytetin e trazuar të Mitrovicës. Ushtarët francez nuk na lejonin të kalojmë në anën tjetër, por ishte edhe e qartë se nuk dinin kënd ta kontaktonin për qartësim.

Qyteti ishte i vdekur. Pas trazirave të para disa ditëve, vendi ishte mbuluar me një qtesë vdekjeje. Duke kaluar urën dhe shumë pika kontrolli, ne e kishim një ndjenjë se ishim në 1942 ose diçka të tillë.

Danezët na ndihmuan më shumë dhe na lejuan të kalojmë në veri. Fshati Çabër ishte një fshat i vogël i banuar me shqiptarë. Sikurse Mitrovicën edhe këtë fshat e ndanë lumi nga fshati fqinjë Zubç.

## A janë fëmijët fajtor?

Një ditë përpara, fshati i varrosi dy nga tre fëmijët e mbytur dhe i treti ende nuk është

gjetur. Lule të frestkëta mundohen ta mbulojnë dhimbjen.

Ne e intervistuam babain e njëres nga viktimat që kishte shpëtuar. Ai ishte i bindur se biri i tij (i mbijetuari) tregonte të vërtetën. "Serbët e bënë këtë. Kjo është planifikuar nga shërbimi sekret serb, i cili vepron lirshëm në veri të Kosovës", tha ai.

Njësojë bindës ishin edhe serbët e fshatit fqinjë të Zubçit të cilët thanë se të gjitha ishin trillime.

Një nga kalimtarët i cili shkante në dasmë na tha se shqiptarët e Zubçit duhet të largohen nga ky fshat dhe duhet të shpërngulen në territorin e shqiptarëve pasi që ky ishte vendbanim i shqiptarëve dhe ata nuk dëshirojnë të jetojnë më së bashku.

Me që kishte shumë dasmorë në këtë dasmë ne vendosëm që të kthehemi. Sidomos për faktin se kishim edhe një qen prapa nesh.

Të nesërmën shkuan në enklavën e Gorazhdecit dhe Bellopojës. Një incident i ngjajshëm me fëmijët serb kishte ndodhur atë verë të vonë në Gorazhdec, kur dy prej tyre ishin vranë.

Përkundër faktit se KFOR-i kishte shtuar prezencën përreth këtij fshati, ne prap nuk patëm vështirësi. Njerëzit ishin shumë të afërt me ne dhe prisnin shpërndarjen e rëndomët të gazetës nga misioni ynë. Më e rëndësishmja, fshati nuk ishte dëmtuar fare.

'Radio Gorazhdec' është në radiostacioni i vogël në këtë enklavë. Këtu ne takuam babain e njërit prej fëmijëve të vranë në një lum tjetër, përseri në rrethana të pasqaruara.

“Shiptari janë fajtor. Ata ma vranë birin tim Pantën,” thoshte ai. I veshur në të zeza dhe bukur i zemruar, mendoja se do të eksplodonte në çdo çast.

## Gjurmët e zemërimit dhe flakës

Destinacioni i fundit ishte fshati i Bellopojë në Kosovën perendimore. Ky fshat ishte vend i kthimeve të reja me rreth 24 kryefamiljarë, të cilët ishin kthyer nga Serbia verën e kaluar. Ata nuk i kishin marrë familjet e tyre gjersa ti dërtonin shtëpitë këtu.

Me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, 24 shtëpi ishin rindërtuar dhe ishin afërsisht të gatshme për banim. Mjerisht, gjatë trazirave, vetëm tri shtëpi kishin shpëtuar sëbashku me kishën e fshatit.

Fshatarët ishin evakuuar në bazën e KFOR-i Italian. Ata po flisnin me nja dhjetë gazetarë, të cilët kishin arritur të depërtonin në bazën e mbikqyrur rrept, në periferi të qytetit të Pejës.

“Ne vendosëm të kthehemi sepse kjo është shtëpia jonë”, tha udhëheqësi i fshatit, i cili vinte po nga ky fshat. “Qiratë janë të shrenjta në Serbi dhe ne dëshirojmë të kthehemi”.

Duke më shikuar me një besim jo edhe aq të plotë, si duket e kuptoi se nuk isha folëse autoktone dhe brengosej se mos ndoshta nuk përktheja çdo gjë që ia thoshte. Madje ai akuzonte njërin nga kolegët tanë të OSBE-së për spiun.

“Ti s’ke nevoj të përkthesh. Ai, (duke bërë me gisht nga shoku im Stuarti nga zyra e OSBE-së në Pejë) flet Serbisht.”

Në përpjekje për ta qetësuar ate i’u drejtova, “Unë nuk kam asnjë përfitim nga keqinterpretimi i fjalëve tuaja dhe Stuarti është anglez. Duhet të më besosh mua. Unë jam nga komuna fqinje e Istogut (vetëm 25 km mëtej)”.

“A keni dëgjuar se vendbanimet serbe në komunën time nuk janë prekur fare”? E pyeta duke u munduar ta fitoj besimin e tij.

“Po kam ndëgjuar se të gjithë janë mirë”, tha ai dhe vazhdoi të fliste.

## Besimi në mentalitetin Ballkanik

Luftrat e përgjakshme në ballkan kanë shkatërruar familje dhe vrarë shumë njerëz. Disa prej dëmeve mund të reparohen. Disa jo. Jetët e humbura të njerëzve duket të na flasin dhe na lusin që ato të jenë të fundit.

Ndërtimi i besimit dhe sigurisë do të jet njëra nga detyrat më të vështira. Duhet të vijë nga të dyja palët. Përpjekjet e njëanshme do të dështojnë.

Një ditë komuniteti ndërkombëtar do të shkoj dhe ne duhet të mësohemi të jetojmë sëbashku sepse ky është vendi që i përkasim. Shtëpia jonë e re do të ket vend për të gjithë ne. Pra, ta ndërtojmë sëbashku. Ndryshme nga kjo, për të mirën tonë.

## Mediat shumetnike:

# ‘Radio K’ në vijën e frontit

nga Arni Snaevarr

Në sheshin përpara objektit të ‘Radios K’, është një monument i ushtarëve të rënë të UÇK-së. Dyqind metra më tutje, mund të shihen shtëpitë e djegura të banorëve serb. Të dyja janë simbole të qeta por të fuqishme të dhunës, e cila ka tronditur Fushë Kosovën në konfliktet e mëhershme dhe atë të fundit.

Emetimi shumetnik asnjëherë nuk është i lehtë në Kosovë, e sigurisht jo në këtë komunë, ku kanë ndodhur disa nga trazirat më të rënda të 17 dhe 18 marsit. Programi i ‘Radio K-s’ është i ndarë në mënyrë të barabartë në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Dy orë në javë janë të dedikuara për dëgjuesit romë dhe ashkalinjë. Si shumica e mediave tjera të Kosovës, ‘Radio K’ ka mbuluar ngjarjet e ‘të mërkures së zezë’ dhe të ditës së nesërme, në programin e saj 24 orësh. Reduktimet e energjisë elektrike kanë penguar transmetimin, por transmetimi dygjuhësor ka vazhduar gjatë tërë kohës, që nga fillimi i trazirave e deri kur stafi serb është dashur të evakuohet për shkak të sigurisë.

## Raportimi nga të dy anët

Duket se ‘Radio K’ ka qenë një vetëm njëri nga disa transmetues në Kosovë që ka patur një qasje shumetnike gjatë raportimit të këtyre trazirave. “Jemi munduar të mbulojmë ngjarjet në mënyrë të paanshme,” thotë Naim Breznica, menaxher i radios. “Kemi bërë shumë përpjekje t’i konfirmojmë informatat para se t’i transmetojmë ato,” shton z. Breznica dhe nxjerr në pah disa raporte të mediave serbe, që thonin se rrugët ishin mbushur me të vrarë dhe të plagosur. “Fatmirësisht, kjo nuk ishte e vërtetë, dhe shpresoj që ne i kemi kontribuar qetësimi të situatës duke dhënë informacione të sakta”. Gjatë dhunës së fundit në Fushë Kosovë një person ka vdekur dhe 12 janë lënduar, tre nga ta me armë zjarri. Raportimi i lajmeve nuk është bazuar në vetëm një burim etnik, si të shumica e mediave të Kosovës në të dy anët e ndarjes etnike. Është e qartë se stafi shumetnik i ka ndihmuar ‘Radios K-së’ të balancojë raportimin e lajmeve.

Në një moment, në qytet u përhapën thashethëme se ‘Radio K’ është djegur dhe stafi i saj është rrahur brutalisht. Edhe kjo doli e pavërtetë. “Nuk ka patur asnjë incident që ka përfshirë radion”, thotë z. Breznica, “përkundrazi, kemi patur numër rekord të telefonatave nga dëgjuesit, të cilët kanë dashur të shprehin falënderimet e tyre për këtë lloj të raportimit”.

## Beteja e pabarabartë

Megjithatë, nuk është sekret se një radio shumetnike ka kundërshtarët e saj në Fushë Kosovë. ‘Radio K’ do të zhvendoset nga objekti i ‘Qendrës së Komunitetit’ kur ajo do t’i

dorëzohet një OJQ-je vendore për shkak të kundërshtimit nga komuna, e cila është pronare e ligjshme e ndërtesës.

‘Radio K’ ka 12 anëtarë të stafit, 4 shqiptarë, 3 serb, 2 romë, 1 ashkali, 1 maqedonas dhe 1 turk.

- A kanë pasur ngjarjet e fundit efekte armiqësore në marrëdhëniet e stafit? Z. Breznica është i paluhatuar:

- “Absolutisht jo. Dy ditë të trazirave nuk mund t’i prishin marrëdhëniet që ne kemi këtu!”

Sa i përket anës financiare, ‘Radio K’ duhet të mbështetet me donacione nga bashkësia ndërkombëtare, duke përfshirë edhe OSBE-në. Si duket, bizneset nuk janë të entuziazmuar të reklamojnë në një radio shumetnike.

## Mos lejoni të humben 5 vite

Përkundër të gjithave, z. Breznica është optimist i kujdesshëm për të ardhmen e një Kosovë shumetnike. “Kam vizituar liderët serb në komunë dhe i kam lutur të tregojnë simpatinë dhe durimin e njëjtë që kanë treguar pas konfliktit në vitin 1999. Kam kërkuar nga ta që të marrin pjesë në institucionet e Kosovës dhe të mos lejojnë që për 2 dytë të shkatërrohen 5 vite të ndërtimit të një shoqërie të re. Unë mendoj se me vullnet të mirë dhe me punë mund t’i afrohem asaj ku kemi qenë më herët për një kohë relativisht të shkurtë.”

Jashtë ‘Radio K-së’, shenjat fizike janë dëshmitar të heshtur të detyrës së madhe para nesh, me rezultate të pasigurtas.



“Ne u pëpoqëm ti mbulojmë ngjarjet pa anime”, thotë përgjegjësi i Radio K-s, Naim Breznica  
Fotografia nga Hans Kristian Kleising



# Kosova shpërthen... transmetim i drejtpërdrejt në TV

Si i mbuluan mediat elektronike të Kosovës trazirat e 17-18 marsit

nga Arni Snaevarr

Shumica e komentatorëve pajtohen se vdekja tragjike e tre fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër ishte një lajm, i cili së paku pjesërisht ndezi zjarin e dhunës etnike që kushtoi 19 jetë njerëzish në trazirat që filluan me 17 mars.

Lajmi i parë i incidentit në natën e 16 marsit u transmetua në lajmet kryesore të mbrëmjes së RTK-së, transmetues publik, në orën 19,30. Prezentuesi i RTK-së e lexoi tekstin e shkurtër duke thënë se policia ishte duke i kërkuar tre fëmijë të zhdukur në lumin Ibër. Zhdukja e tyre mund të ketë pasur lidhje me një zënkë ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Sipas fjalëve të Treisi Beker, zëdhënese e policisë së UNMIK-ut, RTK-ja injoroi kërkesën e Policisë së UNMIK-ut të cilët i kishin lutur posaçërisht gazetarët e RTK-së që mos ta përdorin aluzionin për serbë, "pasi që kjo mund t'i ngrisë tensionet etnike".

Në orën 20,45, RTK-ja filloi të paraqesë titrat në ekran duke i paralajmëruar lajmet e vona të mbrëmjes në emisionin "Blic". Në orën 22:00h, RTV 21, transmetues privat, transmetoi rrefimin e parë të plotë të incidentit në TV, duke raportuar me një ton pa asnjë rezervë se tre fëmijët ishin mbytur në ujë, pasi, "dy serbë... i kishin ndjekur katër fëmijë shqiptarë...dhe derisa përpiqeshin t'u iknin atyre, fëmijët shqiptarë kërcyen në lumin Ibër."

## Thirrja e Kryeministrit

Rrefimi mbi incidentin e Çabrës shpërtheu në kohën a tensioneve të larta në Kosovë. Një granatë dore ishte gjuajtur pak kohë më parë në rezidençën e Kryetarit të Kosovës, z. Ibrahim Rugova; serbët kishin vënë bllokada në rrugë duke protestuar për shkak të plagosjes së një të riu në Çagllavicë. Kjo nuk i shpëtoi vëmendjes së drejtorëve të RTK-së dhe aty rreth orës 22:00h, një orë para se të transmetohej emisioni informativ "Blic", Mufail Limani, kryeredaktor i lajmeve të RTK-së, thërret Kryeministrin për t'a paralajmëruar në lidhje me situatën dhe pasojat e mundshme në Mitrovicë.

Në emisionin informativ të "Blicit", RTK-ja raportoi se tre fëmijët e zhdukur ishin, "...viktima të një sulmi nga një grup serbësh". Sekuenca 12 sekondëshe e zëdhënësit të policisë së UNMIK-ut Beker, duke tërhequr vërejtjen se kjo nuk ishte e konfirmuar mbeti nën hije të intervistës senzacionale me të mbijetuarin 13 vjeçar.

"...Ishim afer lumit...kur disa serbë me një qen na shanë nga shtëpia... dhe ne u përpoqëm të iknim, por nuk mundëm pasi që ishim afer lumit."

Shpjegimi i incidentit pësoi disa ndryshime gjatë ditëve të ardhshme dhe ende nuk është konfirmuar nga policia. Ajo që vërehet është fakti se djali vetë kurrë nuk ka thënë se fëmijët ishin "të ndjekur nga serbët dhe qeni".

RTK-ja vazhdoi me një intervistë të drejtpërdrejtë me Halit Baranin, aktivist kontravers i të drejtave të njeriut, ku i fajësoi 'banditët serbë' për mbytjen në lum të fëmijëve dhe pohoi se kjo ishte një hakmarrje për plagosjen e të riut serb në Çagllavicë.

Përderisa deklarata e kujdeshme e policisë së UNMIK-ut pati hapsirë transmetimi vetëm 12 sekonda, z. Barani pati 1.46 minuta.

Më herët, një korrespondenti i RTK në një raportim të drejtpërdrejtë nga Mitrovica u shpreh se pas 'sulmit' mbi fëmijët 'gati se të gjithë qytetarët' ishin nisur drejt Çabërit.

"Unë u ktheva në media, posaçërisht në RTK dhe KTV dhe u dhash një intervistë të drejtpërdrejtë" tha Treisi Beker, zëdhënese e policisë së UNMIK-ut. "Unë u apeloja njerëzve të qëndrojnë të qetë dhe të qëndrojnë në shtëpitë e tyre në mënyrë që policia të mund të fokusohet në gjetjen e fëmijëve, më mirë sesa të përdoren njërezit për ti shpërndarë turmat. Unë përsëri theksoj se nuk kishim evidencë ti përkrahim thashethëmet se serbët mbytën fëmijët shqiptarë." Asnjë stacion nuk e transmetoi apelin e Beker-it sipas një interviste të shpallur në një raport të përfaqësuesit të OSBE-së mbi 'Lirin e Mediave'. "Gjatë asaj mbrëmje dukej se gazetarët nuk kishin dert se çka ne tham. Ata dukej të i kishin bërë përfundimet e tyre me parë. Çkado që tham ne, ishte e mospërfillur", tha në të njëjtin raport Georgi Kakuk, zëdhënese regjional i UNMIK-ut.

## Trazirat e Kosovës... drejtpërdrejt në TV

Trazirat shpërthyen në Mitrovicë dhe u përhapën në tërë Kosovën pasi që RTK dhe transmetuesit tjerë, TV-të dhe Radiot kombëtare dhe private transmetuan drejtpërdrejt skena nga demonstratat e dhunëshme.

Gjatë gjithë pasdites stacionet televizive transmetonin imazhe të dhunës përfshirë xhirime nga afër të viktimave të plagosura dhe të shokuara. Në Mitrovicë stacionet private shqiptare tregonin pamje të drejtpërdrejta të dhunës të shoqëruara me muzikë patriotike shqiptare. Bernard Vrban, zyrtar i OSBE-së për media



Pika e nxehtë: Protestuesit ballafaqohen me Policinë e UNMIK-ut dhe KFOR-in tek ura e Mitrovicës. Fotografia e UN-it.

thotë: "unë kontaktova drejtorin e stacionit lidhur me këtë sjellje të papranueshme dhe muzika u ndal. Një stacion serb nuk ishte hiq më mirë...atë natë stacioni vazhdoi me një film që përshkruante trajtimin e serbëve në Perandorin Osmane. Kjo gjithashtu nxiste pasionet te pala serbe".

RTK-ja si një transmetues i vetëm publik meriton një vëmendje të posaçme. Më 17 mars RTK transmetoi, intervistë pas interviste ku të dy reporterët dhe bashkëbiseduesit e tyre shprehën mirëkuptim të shpërthimit të dhunës. Në 'edicionin special' të RTK-së zuri vend intervista në vijim në mes të reporterit dhe deputetit të LDK-së në parlament dhe ish aktiviste për të drejta të njeriut, Nekibe Kelmendi.

"RTK: Disa thonë se revolta është e kuptueshme..."

N.K: Natyrisht se është e kuptueshme. Shumë gjëra janë duke u bërë gabimisht këtu (...)

RTK: Si e shihni ju këtë? Policia përdorë forcë dhe lotsjellës kundër protestuesve shqiptarë, kurse serbet lejohen të bllokojnë rrugët me ditë të tëra?

N.K: Kjo është qartë praktikim i standardeve të dyfishta që UNMIK-u ka aplikuar që nga fillimi. Ky është efekti i të ashtuquajturës 'diskriminim pozitiv'...

Intervista tjera me përmbajtje të ngjashme dhe pyetje sugjestive nga gazetarët janë transmetuar gjatë gjithë ditës.

Derisa deputeti i PDK-së, Arsim Bajrami i vlerësoi trazirat si "...revolt legjitime e popullatës shqiptare... një mësim për bashkësinë ndërkombëtare," apelet për qetësi të presidentit dhe kryeministrit janë transmetuar tek në gjysmën e dytë të lajmeve të mbrëmjes, ku kanë dominuar pamjet e dhunës dhe ato dramatike.

## OSBE-ja paralajmëron mediat

Në pasditën e hershme të 17 marsit, Robert Gillete, Komisioneri i Përkohshëm për Media (KPM) iu ka dërguar transmetuesve një apel urgjent përmes e-mailit duke iu kërkuar atyre ta minimizojnë "përmbajtjen emotive të transmetimeve duke informuar por jo ndezur audiencën. Komisioneri për Media ka vizituar të tri televizionet kombëtare për të theksuar këtë porosi. Më vonë, 'Shoqata e Gazetarëve Profesionalist të Kosovës' ka lëshuar një deklaratë në të cilën akuzon KPM-në se përpiqet të cenzuroj lajmet.

Në pasditën e vonë të 17 marsit, Ambasadori Pascal Fieschi, shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë i ftoi në takim drejtorët e të tri televizioneve kombëtare dhe iu përkujtoi atyre mësimin nga Ruanda ku edhe gazetarët janë shpallur përgjegjës për nxitje të dhunës në gjykimet për krime lufte.

Sipas raporteve të OSBE-së, toni i mediave elektronike ka ndryshuar dukshëm vetëm kah fundi i krizës.

(Bazuar në raportet e departamentit për demokratizim pranë OSBE-së, KPM-së dhe përfaqësuesit për liri të mediave)



# KPM-ja akuzon RTK-në për propagandë gjatë trazirave

Robert Gjillete, komisioneri i përkohshëm për media, akuzon drejtorët e RTK-së, TV publik, duke lejuar që “një ndjenjë e shtrembëruar patriotike të mposht profesionalizmin”. Në raportin e tij prej 60 faqesh rreth asaj se si mediat kosovare i trajtuan trazirat e marsit, KPM-ja thotë, “Për 24 orë, që nga mbrëmja e 16 marsit, gazetaria në RTK u shëndrrua në propagandë”.

Përkundër faktit se edhe mediat tjera kanë pasur faj, z. Gjillete kritikoi më të ashpra i’a jep RTK-së në raportimin për vdekjen tragjike të tre fëmijëve shqiptarë më 16 mars. “RTK... e vetme në mesin e tre transmetuesve televiziv nacional në Kosovë... krijoi një kontekst emocional dhe të politizuar për storjen me intervista që i’a mvëshën vdekjen e fëmijëve në mënyrë kategorike ‘banditëve serbë’ dhe ‘hordhive çetnike serbe’ duke mos u bazuar në ndonjë provë”.

KPM-ja ka vërejtur se RTK-ja e ka mbajtur storjen me titra dhe me paraqitje speciale gati vazhdimisht para shikuesve gjë, “që prodhoi një atmosferë eksplozive të histerisë patriotike për këtë tragjedi”. “Në mesë të transmetuesve televiziv kombëtar, RTK-ja ishte kryesisht, në mos ekskluzivisht, përgjegjëse për transferimin e vdekjes tragjike të fëmijëve, nga një lajm tragjik në një teatër të rrezikshëm politik”, konkludon z. Gillete

KPM-ja nuk i kritikoi vetëm raportimin e lajmeve të RTK-së. Kur trazirat shpërthyen më 17 mars, RTK-ja paralajmëroi nëpërmjet njoftimit me tekst ‘edicion special’ derisa shfaqte koncertin e verës së kaluar për nder të Fatmir Limajt, një veteran i UÇK-së i akuzuar për krime lufte, momentalisht duke pritur për gjykim në Tribunalin e Hagës. Derisa teksti

që njoftonte për dhunën në Mitrovicë lëvizte ngadalë në ekran, fytyra e Fatmir Limajt, u paraqit poshtë tekstit me fjalët “Liria Juaj, Liria Jonë” e përcjellur me këndim dhe përhëndetje tjera muzikore të fëmijëve drejtuar Limajt gjatë 22 minutave të ardhshëm. “Kjo ishte hyrja e RTK-së për lajmet e para speciale të ditës që mbuluan dhunën në Mitrovicë. Nën këtë tekst, redaktorët e RTK-së zgjodhën transmetimin e simbolikës së lartë politike, sikur të donin të thërrisnin publikun në mbarë Kosovën që t’a përkujtojnë patriotizmin e tyre në këtë moment të veçantë”, konkludon z. Gillete

RTK-së i takon pjesa më e madhe e kritikës dhe KPM-ja thotë se rivali kryesor i saj, KTV-ja “nuk bëri asgjë t’a politizojë rrëfimin apo ta vendosë atë në një kontekst emocional, patriotik që në një mënyrë të papërgjegjshme rrezikoi nxitjen e zemërimit të publikut dhe acarimin e situatës siç bëri RTK-ja. Megjithatë, disa korrespondentë të KTV-së janë akuzuar për përgatitjen e ‘raporteve tepër të njëanshme’ që nuk ishin të sfiduara apo të korrigjuara. Transmetuesi i tretë, TV 21 thuhet të ketë “dështuar plotësisht në komunikimin e elementit

thelbësor të pasigurisë” duke injoruar deklaratat e policisë së UNMIK-ut në lidhje me mbyrtjen e tre fëmijëve.

Nuk është befasuese që KPM, e cila ka shërbyer si organ regullativ për mediat transmetuese të Kosovës, të bëjë disa rekomandime për transmetuesit, posaçërisht RTK-në. Përderisa rekomandon një shqyrtim të politikës redaktuese dhe implementimin aktiv të kodit të mirësjelljes së RTK-së, ripërtrirjen e ndihmën ndërkombëtare dhe të një këshillëtari të lartë ndërkombëtar, KPM-ja tërheq vërejtjen RTK-së që të mos fajësoj të tjerët, “dhe mos të kërkoj fajin tek personat me pozita më të uëlta në vend se sinqerisht të hulumtoj procesin menaxhues dhe të implementimit të standardeve”.

AS



Komesoneri i përkohshëm për media konkludon se RTK-ja ishte përgjegjëse kryesor nga tri televizionet më të mëdha kosovare për transformimin e vdekjes së tre fëmijëve nga një storje tragjike në një teatër të rrezikshëm politik. Fotografia nga Ola Stojanović

## Raporti kritikon ashpër mediat elektronike

Përfaqësuesi i OSBE-së për Liri të Mediave, z. Miklos Haraszti, ka hetuar në mënyrë të pavarur sjelljen e mediave kosovare. Z. Haraszti, në raportin e tij, ka kritikuar raportimin në mediat kosovare për mbyrtjen e fëmijëve si “shtrembërim kategorik...(që)...duket të mos jetë mbështetur nga ndonjë argument i qëndrueshëm gazetarest.”

“Pa raportimin e pamatur dhe senzacional,” tha z. Haraszti, “ngjarjet do të mund të merrnin një kahje tjetër. Ato mund të mos kishin

arritur intensitetin dhe nivelin e brutalitetit që ne kemi parë, ose mund të mos kishin ndodhur fare.”

Derisa kritikoi mediat kosovare, në veçanti ato elektronike për shfaqje të “një niveli të papranueshëm të emocioneve, njëanshmërisë, pakujdesisë dhe zellit “patriotik” të kuptuar gabimisht”, z. Haraszti nuk i akuzoi ato për “nxitje të qëllimshme të dhunës”. Të tri televizionet kryesore kosovare janë kritikuar për raportimin në mbrëmjen e 16 marsit, në

veçanti RTK-ja, i vetmi transmetues publik.

Sipas këtij raporti, gazetaret kryesore, me disa përjashtime, kanë treguar sjellje konstruktive. Thuhet se editorialet dhe shumica e raporteve në të përditshmet ‘Koha Ditore’ dhe ‘Zeri’ kanë ndihmuar në uljen e tensioneve.

Raporti është bazuar në faktet e mbledhura në terren nga eksperti, z. Dardan Gashi, gazetar dhe autor i dy librave për ballkanin.

AS

# Shërbimi Policor i Kësovës shpëton komunitetin ashkali në Vushtrri

Ngjarjet e 17 dhe 18 marsit në Kosovë ishin tragjike për komunitetin ashkali në Vushtrri, por ishin një sfidë dhe sprovë e madhe për Shërbimin Policor të Kësovës (SHPK).

nga Hasan Sopa

Kadetët e Shërbimit Policor të Kësovës kaluan provë e parë të papritur në trazirat e 17 dhe 18 marsit kur komuniteti ashkali, që jetonte në afërsi të Shkollës Policore të Kosovës, ishte në shëjestër të turmës së mllëfësor.

Atë ditë orët e mësimi po mbaheshin si zakonisht dhe papritmas u dëgjuan detonimet në afërsi të shkollës. “Në atë moment ne si shkollë jemi mundua të mbajmë rregullin dhe bashkëpunimin në mes të gjithë pjestarëve të komuniteteve që vijonin mësimet”, trogon togerja e SHPK-së Aferdita Mikullovc. Sigurisht se atmosfera u rëndua por gjithësesi u dëshmuua profesionalizmi, sepse edhe në ato momente të rënda, ne të gjithë mendonim si polic dhe jo si anëtarë të komuniteteve përkatëse”.

## Duhej shpëtuar jeta e njerëzve të rrezikuar

SHPK- ja kishte marrë urdhërin nga qendra rajonale e Mitrovicës për evakuimin e komunitetit të ashkallijëve që gjenden afër shkollës policore.

“Ne kemi dalë në vendin e ngjarjes shumë shpejtë dhe kjo ndoshta ka ndikuar në parandalimin e më të keqës”, thotë togeri i kësaj shkolle Veton Elshani. “Masa e irrituar e njerëzve ishte nisur për në lagjen e ashkallijëve dhe ne duhet ta ndalonim. Nuk ishte e lehtë të gjendeshe në mes të zjarrit. Por, ne ishim të përgaditur mirë në aspektin psiko-fizik si dhe të pajisur mirë me mjete mbrojtëse, gjë që na ndihmonte shumë. Detyra jonë ishte të shpëtojmë jetën e njerëzve të rrezikuar dhe ne këtë e bëmë me mjaft sukses”.

Për evakuimin më të lehtë dhe më të shpejtë të popullatës, togerja e SHPK-së Aferdita Mikullovc, kishte kërkuar leje për hapej e një hyrje

emergjente nga ana e prapme e shkollës. Këtë gjë drejtorja e shkollës e kishte miratuar pa hezitim dhe ajo u është mirënjohëse për këtë.

“Në mesin e të evakuarve kishte të moshuar, gra, fëmijë, të sëmurë dhe koha nuk lejonte që të shkohej nga hyrja kryesor”, shpjegon togerja Mikullovc.

## Situata do të ishte edhe më e keqe

Pasi ishin vendosur në palestrën sportive të SHPK-së u ishte siguruar ushqim, tesha gjumi dhe medikamente.

“Shumica e grave dhe fëmijëve ishin të friksuar dhe disa nga anëtarët e komunitetit ishin shumë të zemruar me nivelin e mbrojtjes që u ishte ofruar”, thotë Vilson Timothy, shef i planifikimit në SHPK. Ky është një reagim i kuptueshëm, por fakti është se sikur ne të mos kishim bërë asgjë, me siguri situata do të ishte shumë më e keqe”.

Ata qëndruan vetëm disa orë në palestrën sportive të SHPK-së. Diku rreth mesnate kishte ardhur KFOR-i francez dhe i kishte zhvendosur në bazën e tyre, ku gjinden edhe sot e kësaj dite, në pritje të një zgjidhje më të mirë.

Ngjarjet e fundit tragjike dhe veçanërisht rasti në Vushtrri, për SHPK-në ishin një sfidë por ishin edhe një sprovë. Ishte momenti për ta dëshmuar veten dhe aty ku i'u dha rasti ata e bënë këtë.

“Ne jemi krenar me SHPK-në. Ata kanë bërë një përparim të madh dhe shpresoj se kjo ka të bëjë edhe me trajnimet tona që u kemi ofruar. Në fakt ata janë një shërbim i ri policor dhe ende po mësojnë, por kështu është edhe në vendimtim”, thotë Vilson Timothy i cili shërben në këtë institucion që nga themelim.

## Mësimi për institucionet vendimarrëse

Nuk ka dyshim se këto trazirat ishin të dëmshme në radhë të parë për vetë Kosovën. Ishin të dëmshme për institucionet vendore por edhe për faktorin ndërkombëtar. Mbi të gjitha ato i dëmtuan raportet ndëretnike edhe ashtu të brishta. Mirëpo, ndikimi i tyre në institucionin e SHPK-së, si duket ka qenë pozitiv.

“Ngjarjet e fundit kanë ndikuar në forcimin e raporteve ndëretnike dhe njerëzore, po flas për SHPK-në. Ato bile duhet të shërbejnë si mësim për institucionet vendimarrëse, se SHPK-ja është e aftë në menagjimin e krizave dhe marrjen e përgjegjësisë të plota”, përfundon togeri i SHPK-së Veton Elshani.



“Ngjarjet e fundit i kanë forcur raportet ..... ndëretnike” brenda SHPK-së, shprehën kadetët e SHPK-ës Fotografia: Hasan Sopa.

# Personaliteti dhe Procesi: Shqiptarët kthehen në Shtërpcë

Dy figura karizmatike janë të involvuara në suksesin relativ të kthimit të shqiptarëve në Biti të Epërme në Shtërpcë. Majkëll Kërbi u takua me Elez Fejzullahun dhe Zoran Popoviçin

nga Majkëll Kërbi

Pas kanë kaluar më shumë se katër vite si të shpërngulur, më 2003, pesëdhjetë e gjashtë kryefamiljarë shqiptarë u kthyen në Biti të Epërme në Shtërpcë. Kthimi në shtëpi të tyre pas një mungese të gjatë nuk është një operacion që kryhet mbrenda natës dhe kjo iniciativë e posaçme e riintegrimit të komuniteteve ishte kulminacioni i negociatave të zgjata ndërmjet përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare,

zyrtarëve komunal dhe të përfaqësuesve disi armiqësor të fshatrave fqinjë.

Dy figurat më karizmatike të involvuar në kthim në Biti të Epërme janë: Elez Fejzullahu dhe Zoran Popoviç. Të dy këta burra ndejnë lidhje të fortë me tokën e tyre dhe historitë e familjeve të tyre janë të lidhura me Biti të Epërme. Gjithashtu unë do të thoja se Zorani dhe Elezi janë pikë së pari njerëz familjarë e

pastaj përfaqësues të bashkësisë së tyre, më tepër nga nevoja se sa nga dëshira e tyre.

Në moshën 69 vjeçare, bujku sezonal dhe ndërmjetësuesi i konflikteve sipas ‘Kanunit’ të Lekë Dukagjinit i qaset viteve të pleqërisë dhe shikon drejt së ardhmes si një njeri dy herë më i ri. Përkundër një varg problemesh me zemër dhe udhëzimeve të mjekut që t’i ‘redukojë aktivitetet’, z. Fejzullahu gojëmbël vazhdon





Dy nga personazhët më karizmatik të involvuar në kthimin e banorëve në Biti të Epërme, z. Elez Fejzullahu ...

të jet idhtar aktiv i tolerancës ndëretnike dhe mirëkuptimit në mes të komuniteteve.

“Vendi ku je lindë është vendi më i ëmbël,” më tha qetazi z. Elezi duke pirë rishtas një kafe me te. “Unë kam qenë ndërmjetësues familjar për më shumë se 30 vite dhe e di se gjëja e parë që na nevojitet është të ndërtojmë besimin ndërmjet komuniteteve. Unë u lindi në Biti të Epërme por edhe fqinjët e mi serbë u lindën këtu. Ne duhet të jetojmë së bashku dhe e vërteta është se ne nuk mund të jetojmë pa njëri tjetrin.” Si njeri dy herë më i ri se Elezi unë i çmuj shumë fjalët e tij të urta dhe admiroj këmbëngulsinë e tij të arsyeshme në ballafaqim me fatkeqësin.

Zoran Popoviqi, zdrukthëtar i 43 vjeçar, është një mbrojtës shprehës dhe i zëshëm i komunitetit të vet. Edhe pse Zorani e sheh situatën ndryshe dhe ndijen se kthimi i fqinjëve shqiptarë në fshat është i imponuar, prapë prapë ai ka treguar vullnet t'i diskutojë çështjet hapur dhe me sinqeritet me secilin.

“Bashkësia ndërkombëtare po e paraqet situatën shumë të mirë por realiteti është krejtësisht ndryshe,” thotë Popoviqi në dhomën e tij origjinale në një ditë të ftohtë marsi. “Unë kam gruan dhe tre fëmijë dhe krejt çka kemi në këtë fshat janë televizorët tanë dhe një shitore të vogël. Këtu nuk ka asnjë kafene

dhe aq më pak restorante.”

Zoran është mjaft këmbëngulës sa i përket marrëdhënjëve të mira në mes të komuniteteve si dhe në involvimin e tij në procesin e kthimit. “Procesi i kthimit kërkon tolerancë nga të dyja palët. Ne duhet ta dëgjojmë më shumë njëri tjetrin e më pak Beogradin e Prishtinën.

Kur e pyet në lidhje me zhvillimet aktuale, Zorani ngriti duart, “Shiko sa ftohtë është jashtë dhe rrugët janë katastrofale. Unë jam përpjekur t'i përcjellë këto shqetësime të bashkësia ndërkombëtare, por asnjë nga sugjerimet e mia nuk u pranua nga grupi punues komunal i Shtërpcës për kthim apo nga kuvendi komu-



dhe Zoran Popoviqi. Fotografia: Oliver Meko

nal.

Edhe pse Zorani mbetet një zë aktiv në bashkësi, ai ka dhënë dorëheqje nga pjesëmarrja në grupin punues për kthim në mënyrë që të koncentrohet më shumë në përpjekje familjare dhe komerciale. Ishte një dimër i paparashikueshëm në kodrat e Shtërpcës. Nganjëherë është aqë ftohtë, sa që vetëm dy xhaketa dhe zjarri gumëzhitës ofrojnë ngushëllim. Në anën tjetra, duket se pranvera shkriu çdo gjë mbrenda natës, pasi që dielli i zjarrtë, qielli i kaltërt dhe bora e shkrirë shoqërojnë një epokë të re. Ndryshimet ndodhin, deshmë ne apo s'deshmë, dhe ky gjithashtu është një proces.

## Ne do duhej të vallëzonim!

nga Majkëll Kërbi


Herën e parë kur ia përmenda shefit tim vallëzimin dhe fitnesin aerobik si një mjet për ndërtimin e tolerancës multi-etnike reagimi i tij ishte më pak se pozitiv. Ka njerëz që flasin për parimet demokratike dhe normat e barazisë si koncepte teorike, dhe ka të tjerë që faktikisht akuzohen për krijimin e iniciativave vendore për paraqitjen e atyre modeleve. Ndoshta një diskutim në tryezën e rrumbullakët duke involvuar udhëheqësit politik fjalë shumë që përfaqësojnë komunitete të ndryshme etnike tingëllon si thirrje për disa njerëz në Kosovë, por për shumicën e të rinjve të Kosovës kjo është aqë interesante sa edhe për nxënësitë e shkollës ekonomike.

Si një person i interesuar për perspektiva të ndryshme, unë shpeshherë mendohem të pararendojë botën përmes syve të një 13 vjeçari. Kur nuk ngarkohem me ëndërra feminare, e pyesë veten, “në aspekt të tolerancës të bashkë-komuniteteve, si mundet OSBE-ja të ndikojë në gjendjen ekzistuese pa krijimin e një ambienti artificial?” unë kam mësuar nga përvoja me të rinjtë se iniciativa për turnire si për basketboll, kampet e rinisë, dhe aktivitetet kreative arsimore shpiejnë në më shumë rezultate të dëshirurara: respekti, mirëkuptimi dhe identifikimi.

Megjithatë, edhe pse ngurrova në fillim, prapë mora iniciativën për ndërtimin e besueshmërisë për vallëzim dhe fitnes aerobik me koordinatorin i projektit tejet aktiv, Ljubisha Raqeviq, i njohur si Pota. Ljubisha përveç që është drejtor i qendrës për kulturë ‘Sveti Sava’, është në gjendje të bisedojë me njerëz pa përdorur gjuhën e zakonshme. Dhe çka është më e rëndësishmja, pa marrë parasysh bindjen etnike apo fetare, rinia është magnetizuar nga qasja e tij energjetike pozitive për jetën. Sa më shumë që mendova për këtë, kuptova se Pota ishte person i duhur për të ndihmuar të plotësojë zbrastirën në mes të rinjve në komunën e Shtërpcës.

Projekti, ‘Ndërtimin e Besueshmërisë me Vallëzim dhe Fitnes Aerobik’, është një iniciativë që zgjatë një vit në të cilin Misioni i OSBE-së mbështetë aktivitetet për planprograme të veçanta kulturore dhe për

fitnes në të dy fushat, shqiptare dhe serbe në komunën e Shtërpcës. Në këtë projekt tashmë marrin pjesë 110 të rinjë vendor. Të rinjtë e Shtërpcës nuk e marrin këtë si një përpjekje për ndërtim të tolerancës dhe pajtimit, krejt çka dijnë është se vallëzimi është çlirim dhe argëtim.



Ndoshta një tryezë e rrumbullakët përfshirë zëra frymëdhënës politik duket i nevojshëm për të apeluar tek disa kosovarë, por për pjesën dërmuese të rinisë kosovare kjo është po aq interesante sa edhe klasa e shtatë ekonomike. Fotografia: Oliver Meko

# Kampi shumetnik për fëmijë i ndërprerë nga dhuna etnike

Kampi dimëror i mbështetur nga OSBE-ja përfundoi me evakuim nga KFOR-i për shkak të trazirave të 17-18 marsit

nga Arni Snaevarr

Mëngjesi i së mërkurës, 17 mars, kishte pamje paqësore. Dielli shëndriste e bora shkrihej, duke paralajmëruar ardhjen e pranverës. Rreth 50 fëmijë ishin mbledhur në një kamp dimëror shumetnik të rinisë, organizuar nga SHPK-ja. Kush do ta mendonte se atë natë fëmijët do të duhej të evakuoeshin dhe shoqëroheshin nga policia për në shtëpitë e tyre? Natyrisht se kishte detonime, por ishte 'zjarr miqësor': Ushtarët të KFOR-it amerikan, pjesëmarrës të kampit, gjuanin njëri-tjetrin me topa bore.

## "Kemi përdorur gjuhën e shenjave"

51 fëmijë, të moshës 10 deri në 15 vjeçare nga komunat e Ferizajit, Kaçanikut and Shtërpçës kanë qenë pjesëmarrës të kampit së bashku me 6 policë të SHPK-së, dy mësues dhe një doktor lokal, si dhe përfaqësues të KFOR-it.

12 nga fëmijët ishin serb, gjashtë romë, ashkali dhe egjiptianë, të tjerët shqiptarë. Një nga qëllimet e këtij kampi dimëror pesëditor, i cili ishte vazhdimësi e suksesit të kampit veror, ishte ngritja e imazhit të SHPK-së dhe të bashkojë fëmijët jo të privilegjuar nga shumica e grupeve etnike të Kosovës.

Të mërkurën, ditën e tretë të kampit, KFOR-i amerikan udhëhoqi një ditë sportive, e cila ishte ndjekur nga liderët politik lokal, prindërit dhe anëtarët e familjeve të pjesëmarrësve të kampit.

Kampi shkante mirë. Të gjithë fëmijët komunikonin dhe bashkëpunonin. "Është shumë mirë," tha 13 vjeçari Agran Ademi. "Kënaqemi duke lozur. Nuk mund t'i kuptojë fëmijët serb por mundohemi të komunikojmë me gjuhën e shenjave. "Ishte hera e parë edhe për Stojadinka Djoriciqin, 12 dhe Jovana Milosavjeviqin, 13 vjeçare që luanin me fëmijë shqiptarë. "Na ka pëlqyer shoqërimi, por garat akoma më shumë," thanë ato për Detaje.

## Duke pritur Miss Kosovën

Gregori Botrait dhe pjesëtar tjerë të KFOR-it luanin me fëmijët dhe ishte shumë e vështirë të thuhej se kush kënaqej më shumë, fëmijët, pjestarët e SHPK-së apo ushtarët KFOR-it në ambientin e bukur të Brezovicës. Ata mezi prisnin të shihnin dhe dëgjonin Miss Kosovën, e cila pritej të vizitonte kampin dimëror. "Ndoshta do të mbajë fjalim për paqën në botë..." komentoi dikush. Por, nuk do ta dimë nëse Miss Kosova do të fliste për paqën në botë. Derisa fëmijët nga të gjitha grupet etnike të Kosovës merrnin pjesë në tërheqje litari me KFOR-in dhe SHPK-në, adoleshentë vetëm disa vite më të vjetër luftonin luftë të vërtetë me serbët e Kosovës, policinë dhe KFOR-in në Mitrovicë dhe shumë shpejtë u shpërnda në shumicën e komunave të Kosovës.



KFOR-i amerikan në aksion  
Fotografia: Hasan Sopa

## Evakuimi në mesnatë

Është përgjegjësi e madhe të kesh nën përkujdesje fëmijë e të tjerëve dhe, edhe pse udhëheqësit e kampit ishin të fortë, ka qenë barrë e madhe për të siguruar që 51 fëmijë të komunitete të ndryshme, kanë arritur të sigurtë në shtëpi e tyre. Posa është bërë e qartë serioziteti i situatës, në pasditën e 17 marsit është marrë vendim për të mbyllur kampin. Por asnjë autobus civil nuk qarkullonte, ishte edhe më e vështirë të gjindej një shofer i cili do ta kalonte kufirin etnik në Drajkofc.

"Ishte një përvojë rrëqethëse," pranon Aleksandra Simpson nga OSBE-ja, oraganizatore kryesore e kampit, "por të gjithë ishin gjakftohtë."

Vetëm në orët e hershme të ditës së nesërme u gjend zgjidhje për të evakuar fëmijët, të cilët u detyruan të zgjohen në ora 6:20 për tu nisur. KFOR-i përcolli fëmijët deri në Ferizaj dhe Kaçanik, ku prindërit i morën fëmijët e tyre. Aleksandra Simpson ndihej e lehtësuar kur të gjithë fëmijët arritën të sigurt në shtëpi. Përkundër fundit të papritur dhe dramatik, "qëllimi i kampit të SHPK-së ishte ngritja e kuadrove, dhe kjo u arrit, tha ajo, edhe pse në rrethana të vështira. Policët udhëheqës të SHPK-së nga Ferizaji dhe Shtërpca duhet të lavdërohen për gjakftohtësi në ballafaqim me situatën dhe në evakuimin e anëtarëve të kampit pa përhapur panik tek fëmijët.



Tërheqje e litarit pa hidhërim në Brezovicë pikrisht në momentin e shpërthimit të dhunës ndëretnike në Mitrovicë  
Fotografia: Hasan Sopa.